



Prishtine, data: 16.03.2021

KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE - Ne baze te Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimit dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, ne lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 382 dt.13.02.2013 mbi shqiptimin e gjobës administrative ndaj: **Sheqë Lladrovci** person fizik, me adresë; fshati Zhilivod, Komuna e Vushtrisë, merr këtë vendim :

AKTVENDIM

1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtresave për **Sheqë Lladrovci** person fizik, me adresë; fshati Zhilivod, Komuna e Vushtrisë, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

Arsyetim

Ndaj **Sheqë Lladrovci** person fizik, me adresë; fshati Zhilivod, Komuna e Vushtrisë, KPMM ka leshuar aktin administrativ me nr. 382 dt.13.02.2013.

Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt.11.09.2017 dhe me dt.04.07.2018 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .



Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA E KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE NEZAVISNA KOMISIJA ZA RUDNIKE I MINERALE INDEPENDENT COMMISSION FOR MINES AND MINERALS	
DALJE	
DEPISEK	NR. PROT
DEPISEK	BR. PROT
DEPISEK	NR. PROT
1026	
NUMRI I FAKTIVE	DD.MM.VVVV
BROJ STRANA	DD.MM.GGGG
NR. OF PAGES	DD.MM.YYYY
16.03.2021	
PRISHTINE/A	



Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Prishtinë, 11.02.2013/12


Në pajtim me nenin 79 paragrafet 3,4 dhe 5 të ligjit nr. 03/L-163 për Minicrat dhe Minerale, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nxjerr këtë:

AKTVENDIM

Ndaj Sheqë LLadrovcit person fizik me nr. të telefonit 044/522-841, me adresë; fshati Zhilivod, Komuna e Vushtrisë.

1. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 3 shqiptohet gjoba administrative për shfrytëzimin e resurseve minerare e cila është e barabarte me trefishin e shumës së rentave minerare të cilat duhet të paguhen për mineralet e shfrytëzuar ose eksploatuar e cila është **8,710.42€**
2. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 shqiptohet gjobe administrative për shfrytëzim ilegal në shumë prej **5,000.00€**
3. Dhe në pajtim me nenin 79 paragrafi 5 shqiptohet gjobe administrative në mënyrë kumulative (grumbulluese) lidhur me paragrafet 3 dhe 4 të këtij neni e cila është në shumën e përgjithshme prej **13,710.42€**

Arsyetim



Gjatë inspektimit të operimeve ilegale me datën 09.11.2012, person fizik Sheqë LLadrovcit është hasur duke operuar ilegalisht në shfrytëzimin e resurseve minerale. Shfrytëzimi i resurseve minerare është bërë në lokacionin që gjendet fshatin Zhilivod komuna e Vushtrisë. Inspektorët e Minerave kanë konstatuar se ju keni ushtruar aktivitet të paligjshëm pa u pajisur me Licencë të Shfrytëzimit. Lloji i mineralit që ju shfrytëzonit ishte Qymyr.

Ju jeni udhëruar me anë të urdhëresës për ndërprerje të aktivitetit ilegal të lëshuar nga Inspektorët në datën e inspektimit që menjëher të ndërprej aktivitetin e paligjshëm.

Inspektorët e Minerave kanë konstatuar se Sheqë LLadrovcit aktivitetin e operimeve ilegale e bënte në lokacionin me keto koordinata: Y= 7500425, 7500468, 7500445; X= 4729118, 4729114, 4729133; Z= 565, 571, 570, për të cilat koordinata nuk keni poseduar Licencë për Shfrytëzimin e mineraleve të Qymyrit.

Me datën 10.12.2012, Departamenti i Gjeodezisë në KPMM-së ka kryer matjet gjeodezike në fushën e shfrytëzimit e cila sasi e shfrytëzuar e mineralit të Qymyrit është prej **10,152.00.m3**

Rr. Armend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosove
Tel: +381 (38) 240 252
Fax: +381 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Afati për kryerjen e pagesaës së gjobës administrative është 15 ditë nga dita e pranimi të këtij aktvendimi, pagesa e faturës bëhet në Bankën Qendrore të Kosovës në këtë xhironlogari 1000430070005950.

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.


Aktvendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga Drejtori i KPMM

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka marrë njoftimin për nxjerrjen e aktvendimit. Ankimi administrativ i drejtohet Komisionit për Ankesa të KPMM.

Sipas nenit 128.2 të Ligjit për Procedurën Administrative, ankimi administrativ nuk e pezullon zbatimin e aktvendimit, sepse aktvendimi synon mbledhjen e taksave, tatimeve ose të ardhurave të tjera buxhetore.

Aktvendimi t'i dergohet:

Arkivesë së KPMM-së,
Departamentit të Finacave të KPMM-së,
Palës



Miroslav Bojaxhiu

Drejtor

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale